



VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

Për tremujorin e parë 2022

2

0

2

2

Prill, 2022

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

Shënime të përgjithshme

Pyetësi i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues synon të mbledhë opinionin e bankave tregtare lidhur me zhvillimet e tre muajve më të fundit në ofertën dhe kërkesën për kredi, si dhe pritjet e tyre për tremujorin e ardhshëm. Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues jep në mënyrë të përmbledhur perceptimet e bankave mbi ndryshimet në kushtet e ofertës për kredi - ilustruar nëpërmjet standardeve, kushteve e termave të kreditimit dhe kredive të miratuara - si dhe mbi ndryshimet në kërkesën për kredi, si për bizneset ashtu edhe për individët. Kjo analizë bazohet në rezultatet e agreguara nga përgjigjet e dhjetë bankave, të cilat zotërojnë peshën më të madhe të stokut të kredisë së dhënë për sektorin privat.

Pyetësi, në vija të përgjithshme, ndjek praktikën e ndjekur nga Banka Qendrore Evropiane, por është i përshtatur me specifikat e tregut tonë të kredisë për sektorin privat. Paralelisht, ndryshe nga praktikat e tjera, seritë e treguesve janë testuar për praninë e sezonalitetit dhe, aty ku ky efekt shfaqet, seritë janë korrigjuar. Për më shumë detaje, Pyetësin e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues së bashku me fjalorin e termave të përdorur në të, një material të shkurtër mbi rëndësinë e këtij vrojtimi, disa aspekte metodologjike, si dhe seritë e përdorura në analizë, i gjeni të publikuar në adresën:

https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/

PËRMBLEDHJE

Standardet e kreditimit për bizneset u shtrënguan vetëm në segmentin e biznesit të vogël e të mesëm. Shtimi i pasigurive, si pasojë e ecurisë së çmimeve në tregjet ndërkombëtare e ato vendase, ka nxitur bankat të jenë disi më konservatore ndaj këtij segmenti të biznesit. Nga ana tjetër, standardet e kreditimit nuk ndryshuan për segmentin e biznesit të madh, e në kreditë e reja të lëvruara për financimin e inventarëve e kapitalit qarkullues. Së bashku me standardet, bankat shtrënguan edhe kushtet e termat e kreditimit për bizneset – kryesisht ato të vogla e të mesme – në këtë tremujor. Kujdesi i shtuar i bankave në kreditimin e bizneseve, u reflektua edhe në një shkallë më të ulët miratimi kredish në tremujorin e parë. Bizneset, nga ana tjetër, kanë shtuar dukshëm kërkesën për kredi për të katërtin tremujor me radhë, me qëllim financimin e investimeve të planifikuara dhe të inventarëve e kapitalit qarkullues, në të gjitha kategoritë e madhësisë së biznesit.

Standardet e kreditimit për individët u lehtësuan në tremujorin e parë. Njëkohësisht, bankat lehtësuan edhe kushtet e termat për kreditë e reja akorduar individëve. Shtimi i konkurrencës në sistemin bankar duket se ka shtyrë bankat të aplikojnë politika më lehtësuese për kreditimin e individëve gjatë këtij tremujori. Kjo reflektohet dhe në shkallën e miratimit të kredive, e cila, sipas raportimit të bankave, shënoi rritje edhe këtë tremujor. Kërkesa për kredi ishte e lartë, sidomos në kreditë për blerjen e banesave.

Bankat presin që e njëjta tablo e kushteve të ofertës dhe kërkesës për kredi të mbartet edhe në tremujorin e dytë të vitit 2022. Kështu, bankat pritet të vijojnë kujdesin e shtuar kundrejt kreditimit të bizneseve, ndërkohë që për individët të mbajnë një përjasje më lehtësuese kreditimi. Kërkesa për kredi, si nga ana e bizneseve ashtu edhe e individëve, pritet të vijë në rritje. Shtimi i kërkesës për kredi në të dyja kategoritë pritet të jetë me bazë të gjerë, në terma të qëllimit të përdorimit të kredisë.


KUSHTET E OFERTËS DHE KËRKESA PËR KREDI

1. KREDIA PËR BIZNESE

1.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për bizneset u shtrënguan vetëm në segmentin e biznesit të vogël e të mesëm, në tremujorin e parë të vitit 2022. Për biznesin e madh, standardet e kreditimit mbetën të pandryshuara. Po ashtu, standardet e kreditimit nuk ndryshuan në kreditë dhënë me qëllim mbulimin e nevojave për likuiditet, ndërkohë që ato u shtrënguan në kreditë për qëllime investimi.

Grafik 1. Standardet e kreditimit për bizneset dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm¹




¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Faktorët që sollën shtrëngimin e standardeve të kreditimit për bizneset në këtë tremujor ishin të lidhur me perceptimin e rrezikut për elementët si: situata ekonomike në vend dhe perspektiva për të; aftësia paguese e kredimarrësit; si edhe kolaterali i kërkuar. Po ashtu, edhe toleranca më e ulët e bankave kundrejt rrezikut ndikoi në shtrëngimin e standardeve. Në kahun lehtësues, ndikuan kostot dhe kufizimet më të ulëta nga bilanci i bankave.

Grafik 2. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e bizneseve²



²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e dytë të vitit 2022, bankat presin një tablo të ngjashme të standardeve të kreditimit me tremujorin e parë (*Grafik 1*). Kështu, standardet e kreditimit priten të mbeten të shtrënguara në segmentin e biznesit të vogël e të mesëm dhe të pandryshuara në segmentin e biznesit të madh. Shtrëngimi i standardeve pritet të jetë evident në kreditë për qëllime investimi, ndërkohë që standardet në kreditë për qëllime likuiditeti priten të mbeten thuajse të pandryshuara me tremujorin e parë.

1.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm mbi kreditë e reja disbursuar bizneseve u shtrënguan në tremujorin e parë të vitit. Shtrëngimi i tyre u arrit si nga elementet çmim, ashtu edhe ato joçmim. Kështu, bankat raportuan marzhe më të larta mbi kreditë me rrezik, reduktuan madhësinë e kredisë akorduar bizneseve, si edhe shtuan numrin e kushtëzimeve në marrëveshjet e kredisë, të nënshkruara mes bankave dhe bizneseve. Në kahun lehtësues të kushteve e termave të kreditimit ndikuan marzhet më të ulëta mbi kreditë normale, si edhe zgjatja e maturitetit maksimal të kredisë.

Grafik 3. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për bizneset³




³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe termat të lehtësuar, ndërsa ato negative tregojnë kushte dhe termat të shtrënguara.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në gjykimin e bankave, shtrëngimi i kushteve dhe termave të kreditimit për bizneset u ndikua nga perceptimi për rrezik të shtuar, si edhe nga toleranca më e ulët e bankave kundrejt rrezikut.

Grafik 4. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e bizneseve⁴




⁴: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative tregojnë kushte dhe termat të shtrëngimit të tyre.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.3. Shkalla e miratimit të kredive

Shkalla e miratimit të kredive për bizneset u raportua më e ulët në tremujorin e parë të vitit. Pothuajse të gjithë faktorët që përcaktojnë shkallën e refuzimeve për kredi të bizneseve kanë vepruar në kahun rritës të refuzimeve në këtë tremujor. Kështu, perceptimi i bankave për rrezikun lidhur me perspektivën e sektorit ku operojnë bizneset, me gjendjen financiare të bizneseve; faktorët e lidhur me kuadrin e politikave të kreditimit të bankave, me aftësinë paguese të kredimarrësit; si dhe historiku i kreditit nga regjistri i kredive dhe statusi i kredive aktuale, ndikuan në shtimin e numrit të refuzimeve për kredi gjatë këtij tremujori. I vetmi element me ndikim rënës në shkallën e refuzimeve u raportua historiku i marrëdhënieve të biznesit me bankën.

Grafik 5. Raporti i aplikimeve të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi të bizneseve (majtas) dhe faktorët që kanë diktuar në vendimet e bankave⁵




⁵: Vlerat pozitive tregojnë rritje të raportit të refuzimeve ndaj totalit të aplikimeve për kredi (grafiku në të majtë). Po ashtu, vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në rritjen e raportit të refuzimeve (grafiku në të djathtë), ndërsa ato negative në reduktimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.4. Kërkesa për kredi

Kërkesa për kredi e bizneseve u raportua e lartë edhe në tremujorin e parë të vitit 2022. Shtimi i kërkesës për kredi u vërejt si në terma të qëllimit të përdorimit të kredisë, ashtu edhe në terma të madhësisë së biznesit. Balancat e kërkesës për kredi shënuan vlera të larta pozitive, edhe këtë tremujor, si në kreditë për biznesin e vogël e të mesëm, ashtu edhe në atë madh. Po ashtu, si kërkesa për kredi për qëllime investimi, ashtu edhe ajo për mbulimin e nevojave për likuiditete u raportua e shtuar këtë tremujor.


Grafik 6. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për bizneset⁶



⁶: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shtimi i kërkesës për kredi nga bizneset në tremujorin e parë të vitit, sipas gjykimit të bankave, u ndikua kryesisht nga nevojat më të larta për financimin e inventarëve dhe kapitalit qarkullues, për financimin e investimeve, si dhe për ristrukturimin e kompanive. Faktori i vetëm me ndikim në kahun rënës të kërkesës për kredi u raportua përdorimi i burimeve alternative të financimit.

Grafik 7. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi nga bizneset⁷



⁷: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie e saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Bankat gjykojnë se në tremujorin e dytë të vitit 2022, kërkesa për kredi e bizneseve do të jetë sërish e lartë, si nga bizneset e vogla e të mesme, ashtu edhe nga bizneset e mëdha (*Grafik 6*). Në prizmin e qëllimit të përdorimit, kërkesa për kredi pritet të jetë e lartë vetëm për mbulimin e nevojave për likuiditet, ndërkohë që kredia për investime pritet të mbetet e pandryshuar krahasuar me tremujorin e parë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

2.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për individët u lehtësuan në tremujorin e parë të vitit 2022. Lehtësimi i standardeve u vërejt në të dyja kategoritë e qëllimit të përdorimit të kredisë, ndonëse ishte më i theksuar në kreditë konsumatore.


Grafik 8. Standardet e kreditimit për individët dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm⁸



⁸: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të tyre.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lehtësimi i standardeve të kreditimit për individët u arrit nga konkurrenca e shtuar në sistemin bankar, si edhe perceptimi i bankave lidhur me zhvillimet aktuale e të pritura në tregun e banesave. Në të kundërt me to veprimi perceptimi i rrezikut lidhur me situatën ekonomike në vend dhe perspektivën për të.

Grafik 9. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e individëve⁹




⁹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e dytë të vitit 2022, bankat presin t'i lehtësojnë më tej standardet e kreditimit për individët, si në kreditë për blerjen e banesave, ashtu dhe ato konsumatore (Grafik 8).

2.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm për kreditë akorduar individëve u lehtësuan në tremujorin e parë. Lehtësimi i kushteve dhe termave të kreditimit erdhi si pasojë e zgjatjes së afatit maksimal të maturitetit për kreditë dhënë individëve. Marzhet më të larta mbi kreditë me rrezik, si edhe kërkesat më të larta për kolateral në raport me kredinë e marrë – në kreditë për blerje banesash - ndikuan në kahun shtrëngues të kushteve e termave të kreditimit.

Grafik 10. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për individët¹⁰



¹⁰: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuar, ndërsa ato negative të shtrënguar.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Trysnia më e lartë nga konkurrenca në sistem bankar diktoi lehtësimin e kushteve e termave të kreditimit në këtë tremujor. Faktorët e tjerë që ndikojnë kushtet e termat e kreditimit për individët mbetën të pandryshuar.

Grafik 11. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e individëve¹¹



¹¹: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e tyre.


Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3. Shkalla e miratimit të kredive

Bankat raportuan rritjen e shkallës së miratimit të kredive për individët edhe në tremujorin e parë të vitit 2022. Numri më i ulët i refuzimeve për kredi të individëve erdhi si pasojë e perceptimit të bankave për përmirësimin e treguesve lidhur me aftësinë paguese - të ardhurat e disponueshme dhe

historiku i punësimit e stabiliteti në tregun e punës; nga politikat e bankave lidhur me dokumentacionin e kërkuar, si edhe statusi prej regjistrimit të kredive. Në kah të kundërt me to u raportuan gjendja e kredive aktuale, si edhe mungesa e kolateralit.

Grafik 12. Raporti i aplikimeve të refuzuara ndaj totalit të aplikimeve për kredi të individëve (majtas) dhe faktorët që kanë diktuar në vendimet e bankave¹²




¹²: Vlerat pozitive tregojnë rritje të raportit të refuzimeve ndaj totalit të aplikimeve për kredi (grafiku në të majtë). Po ashtu, vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në rritjen e raportit të refuzimeve (grafiku në të djathtë), ndërsa ato negative në reduktimin e tyre. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4. Kërkesa për kredi

Kërkesa e individëve për kredi u perceptua e lartë edhe në tremujorin e parë të vitit, nxitur kryesisht nga kreditë për blerjen e banesave. Në tremujorin e dytë të vitit 2022, bankat presin që kërkesa për kredi të jetë sërish e lartë, si ajo për blerjen e banesave, ashtu edhe ajo për financimin e konsumit.


Grafik 13. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për individët¹³



¹³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas gjykimit të bankave, rritja e kërkesës për kredi nga individët i atribuohet nevojave të shtuara për kredi në financimin e blerjes së banesave dhe të konsumit, si edhe zhvillimeve aktuale e të pritura në tregun e banesave. Bankat po ashtu raportuan se fushatat e marketingut të ndërmarra prej tyre për kreditë për blerje banesash, kishin nxitur kërkesën për kredi të individëve gjatë këtij tremujori.

Grafik 14. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për individët¹⁴



¹⁴: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënien e saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.